

data e kerkeses:

11.10.2024

Objekti i kerkeses :

1. Cilat janë degët e hapura për vitin akademik aktual në Universitetin e Vlorës?
2. A ka degë që janë mbyllur gjatë viteve të fundit, dhe nëse po, cilat janë ato dhe arsyet për këtë vendim?
3. Cilat janë kriteret që përdoren për të vendosur nëse një degë duhet të mbyllet apo të mbetet e hapur?
4. A ka degë të reja që janë planifikuar të hapen në të ardhmen e afërt?
5. Sa studentë ka pasur universiteti në 5 vitet e fundit të ndara sipas viteve dhe fakulteteve?

data e pergjigjes :

18.10.2024

Pergjigja:

1. Përsa i përket pikës së parë: Cilat janë degët e hapura për vitin akademik aktual në Universitetin e Vlorës? ju informojmë se:

· Me vendimin e Senatit Akademik Nr. 4, dt. 06.02.2023 “Për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në të gjitha ciklet e studimit, për vitin akademik 2024-2025, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë” janë miratuar kriteret e pranimit për të gjitha programet e studimit që ofrohen në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, për vitin akademik 2024-2025. Bashkëlidhur do të gjeni Vendimin Nr. 4, dt 06.02.2023.

· Në kuadër të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Vendimi i mësipërm është i aksesueshëm në faqen WEB të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë.

2. Në lidhje me pikën e dytë: A ka degë që janë mbyllur gjatë viteve të fundit, dhe nëse po, cilat janë ato arsyet për këtë vendim? Ju bëjmë me dije se:

· Me vendimin e Senatit Akademik Nr. 52, dt 06.10.2023 “Për numrin minimal të programeve të studimit të ciklit të parë që nuk do të aktivizohen për vitin akademik 2023-2024 në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë” është vendosur:

a. Numri minimal i studentëve të regjistruar që mundësojnë aktivizimin e një programi studimi për ciklin e parë të studimit në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, të cilët nuk do të jenë prioritet kombëtar dhe nuk janë pjesë e fushave dhe programeve të Vendimit nr.386, dt 01.06.2022 do të jetë 5 (pesë).

b. Numri minimal i studentëve të regjistruar që mundësojnë aktivizimin e një programi studimi për ciklin e parë të studimit në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, të cilët janë prioritet kombëtar dhe janë pjesë e fushave dhe programeve të Vendimit nr.386, dt 01.06.2022 do të jetë 3 (tre).

Bazuar në këtë vendim për vitin akademik 2023-2024 nuk janë aktivizuar programet e studimit të ciklit të parë si më poshtë:

Gjuhë Italiane (FSHH)

Kimi (FSHTN)

Matematikë (FSHTN) - (Bashkelidhur Vendimi)

· Me vendimin e Senatit Akademik Nr. 43, dt 08.10.2024 “Për numrin minimal të programeve të studimit të ciklit të parë që nuk do të aktivizohen për vitin akademik 2024-2025 në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë” është vendosur:

a. Numri minimal i studentëve të regjistruar që mundësojnë aktivizimin e një programi studimi për ciklin e parë të studimit në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, të cilët nuk do

b. Numri minimal i studentëve të regjistruar që mundësojnë aktivizimin e një programi studimi për ciklin e parë të studimit në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, të cilët janë prioritet kombëtar dhe janë pjesë e fushave dhe programeve të Vendimit nr.386, dt 01.06.2022 do të jetë 3 (tre).

Bazuar në këtë vendim për vitin akademik 2024-2025 nuk janë aktivizuar programet e studimit të ciklit të parë si më poshtë:

Matematikë-fizikë (FSHTN)

Gjuhë Italiane(FSHH)

Gjuhësi e Aplikuar në Fushën e Turizmit (FSHH) – (Bashkelidhur Vendimi)

Arsyeja e mos aktivizimit të këtyre programeve të studimit është mospërbushja e detyrimit për plotësimin e numrin minimal të studentëve të regjistruar në këto programe.

3. Në lidhje me pikën e tretë: Cilat janë kriteret që përdoren për të vendosur nëse një degë duhet të mbyllet apo të mbetet hapur? Ju informojmë se:

Vendimet e Senatit Akademik për hapjen dhe mbylljen e programeve të studimit bëhen në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 35, “Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i

programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë” dhe Udhëzimit Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, Kreu IV, pika A, “Dokumentacioni dhe procedura për hapjen e programeve të studimit” dhe C, “Procedurat për mbylljen e programeve të studimit”.

Për procedurat për mbylljen e programeve të studimit, në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020 citohet se:

1. Akti për hapjen e një programi studimi shfuqizohet në rastet si më poshtë:

- a) IAL-ja aplikon në platformën e-Albania, sipas formularit përkatës për mbylljen e programit/eve të studimit, jo më vonë se 6 muaj para fillimit të vitit të ri akademik. Subjekti ngarkon kërkesën e argumentuar, shoqëruar me propozimet e njësisë bazë dhe të njësisë kryesore, si dhe vendimet përkatëse të Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit. IAL-ja është përgjegjëse për pasojat juridike të ardhura nga mbyllja e programit/eve të studimit për studentët që kanë përfunduar programin apo janë në proces ndjekjeje të programit.
- b) kur IAL-ja nuk e aktivizon programin brenda dy viteve akademike të njëpasnjëshme nga dalja e urdhrimit të hapjes, leja e dhënë për hapjen e këtij programi studimi bëhet e pavlefshme të studimit. IAL-ja duhet të garantojë përfundimin e studimeve për studentët e regjistruar në programin që kërkohet të mbyllet.

3. Studentët që nuk kanë përfunduar ende studimet në programin që mbyllet, kanë të drejtë të transferojnë studimet brenda të njëjtit institucion ose në një institucion tjetër të arsimit të lartë

Gjithashtu Kreu VI, “Dispozitat tranzitore dhe të fundit” pika 6, përcakton se:

6. Mbyllja e programeve të studimit bëhet me urdher të ministrit përgjegjës për arsimin. Kur programi mbyllet me kërkesë të institucionit të arsimit të lartë, paraprakisht duhet të garantojë përfundimin e studimeve për studentët në proces.

Një nga kriteret bazë që mundëson aktivizimin e një programi studimi të ciklit të parë të studimit në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë është numri i studentëve të regjistruar.

Vendimet e Senatit përcaktojnë numrin minimal të studentëve të regjistruar që mundësojnë

aktivizimin e një programi studimi.

4. Për pikën katërt: A ka degë të reja që janë planifikuar të hapen në të ardhmen e afërt?

Propozimet për hapjen e programeve të studimit bëhen më kërkesë të njësisë bazë ku do të ofrohet programi i studimit. Planifikime për hapjen e programeve të reja të studimit ka dhe jemi në proces aplikimi.

5. Në përgjigje të pikës së pestë: Sa student ka pasur universiteti në 5 vitet e fundit të ndara sipas viteve dhe fakulteteve? bashkëlidhur do të gjeni pasqyrimin e të dhënave të kërkuara, (numrin e studentëve në rang universiteti për vitet 2020-2024) në tabelën exel. Për këtë vit akademik (2024-2025) afati i regjistrimeve nuk ka përfunduar ende, jemi në procesin e regjistrimeve, në fazën pas Raundit të dytë që përfshin datat: 10.10.2024-25.10.2024. Gjatë kësaj faze regjistrohen studentë në vende të mbetura bosh.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Menyra e perfundimit :

Me email

Tarifa

Pa pagese

data e kërkeses:

14.10.2024

Objekti i kërkeses

Sa është numri i studentëve të regjistruar deri më tani për vitin akademik 2024-2025?

Specifikimet vetëm sipas fakulteteve!

2- Sa është numri i degëve në Universitetin “ISMAIL QEMALI” për këtë vit akademik?

3- Sa studentë janë mbyllur për këtë vit akademik dhe cilat degë janë mbyllur?

4- Sa studentë u regjistruan në vitin akademik 2019-2020 në Universitetin “ISMAIL QEMALI”

Specifikimet vetëm sipas fakulteteve!

5- Sa studentë u regjistruan në vitin akademik 2014-2015 në Universitetin “ISMAIL QEMALI”

Specifikimet vetëm sipas Fakulteteve!

6- Sa programe studimi ka aktualisht në pesë fakultetet e Universitetit “ISMAIL QEMALI”

7- Sa programe studimi ka pasur në vitin 2014?

8- A keni mbyllur programe studimi për shkak të mungesës së studentëve?

9- A keni aktualisht programe studimi të nivelit Bachelor me më pak se 10 studentë? Cilat janë ato?

data e pergjigjes:

23.10.2024

Pergjigja:

1. **Përsa i përket pikës së parë: Sa është numri i studenteve të regjistruar deri me tani për vitin akademik 2024-2025?,**

Për Fakultetin e Shendetit regjistrimet e studenteve për programet e studimit (Bachelor) vitin akademik 2024-2025 janë:

- Infermieri e Pergjithshme 180 studente.
- Infermieri Mami janë 67 studente

Ndresa për fakultetet e tjera bashkelidhur do të gjeni informacionin të ndare sipas të 3 (tre) Njesive Kryesore perkatese (FSHTN,FSHH,FE), paraqitur në tabelen exel.

Për këtë vit akademik (2024-2025) afati i regjistrimeve për programet e studimit të Ciklit të II (Master)nuk ka përfunduar ende, afati mbyllet në dt.25.10.2024.

Nuk mund tju japim një informacion të detajuar duke qene se jemi akoma në procesin e regjistrimeve,

2. **Në lidhje me pikën e dytë: Sa është numri i degëve në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, për këtë vit akademik?, Ju bëjmë me dije se:**

· Me vendimin e Senatit Akademik Nr. 4, dt. 06.02.2023 ***“Për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve në të gjitha ciklet e studimit, për vitin akademik 2024-2025, në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë”*** janë miratuar kriteret e pranimit për të gjitha programet e studimit që ofrohen në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, për vitin akademik 2024-2025. Bashkelidhur do të gjeni Vendimin Nr. 4, dt 06.02.2023. (bashkelidhur vendimi nr.4, dt 06.02.2023).

3. **Për pikën e tretë: Sa studente janë mbyllur për këtë vit akademik dhe cilat dege janë mbyllur?, Ju informojmë se:**

Nuk ka programe studimi (dege) qe jane mbyllur per kete vit akademik. Por me vendimin e Senatit Akademik Nr. 43, dt 08.10.2024 **“Për numrin minimal të programeve të studimit të ciklit të parë që nuk do të aktivizohen për vitin akademik 2024-2025 në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë”** është vendosur:

Të mos aktivizohen programet e studimit të ciklit të parë si më poshtë:

- **Matematikë-fizikë (FSHTN)**
- **Gjuhë Italiane(FSHH)**
- **Gjuhësi e Aplikuar në Fushën e Turizmit (FSHH) – (Bashkelidhur Vendimi)**

Arsyeja që nuk janë aktivizuar këto programe studimi është mospërmbushja e detyrimit për plotësimin e numrin minimal të studentëve të regjistruar në këto programe.

4. Për pikën katërt: Sa studentë u regjistruan ne vitin akademik 2019-2020 ne Universitetin “Ismail Qemali” Vlore?, bashkelidhur do te gjeni informacionin e kerkuar, te ndare sipas fakulteteve perkatese, paraqitur ne tabelen exel.

5. Në përgjigje të pikes së pestë: Sa studentë u regjistruan per vitin akademik 2014-2015 ne Universitetin “Ismail Qemali” Vlore, po ju japim informacion me te detajuar ne piken e 7 (shtate), ku do te pasqyrohen programet e studimit si dhe studentet e regjistruar ne keto programe studimi per vitin akademik 2014-2015.

6. Ne pergjigje te pikes se gjashte: Sa programe studimi ka aktualisht ne pese fakultetet e Universitetit “Ismail Qemali” Vlore?, se pari ju informojme se Universiteti yne ka ne perberje te tij 4 (kater) Njesi kryesore (Fakultete), dhe programet e studimit per kete vit akademik janë sipas tabeles exel bashkelidhur email-it.

7. Per piken e shtate: Sa programe studimi ka pasur ne vitin 2014?, në bazë të informacioneve që kemi ne dispozicion ju informojme se programet e studimit per vitin akademik 2014-2015 si dhe numri i studenteve te regjistruar ne keto programe ka qene:

FSHT

NR.	Fakulteti i Shkencave Teknike/Programet e Studimit	Numri studenteve te regjistruar per vitin akademik 2014-2015
1	<i>Bachelor ne Inxhinieri Mekanike</i>	62
2	<i>Bachelor ne Inxhinieri Navale</i>	23
3	<i>Bachelor ne Inxhinieri Elektrike</i>	27
4	<i>Bachelor ne Navigacion dhe Peshkim</i>	17
5	<i>Bachelor ne Biologji</i>	73
6	<i>Bachelor ne Matematike</i>	21
7	<i>Bachelor ne Informatike</i>	75
8	<i>Bachelor ne Teknologji Informacioni</i>	38

9	<i>Bachelor ne Shkenca Kompjuterike</i>	51
10	<i>MS ne Shkenca Kompjuterike</i>	9
11	<i>MS ne Biologji Mjedisore</i>	9
12	<i>MP Mesimdhenie ne Biologji me profil Minor ne Kimi</i>	11
13	<i>MP i Mesuesise per Arsimin e Mesem ne Lenden Matematike</i>	1
14	<i>MP Mesuesi ne CLAB per lendet Matematike-Fizike</i>	5
15	<i>MP "Operacione Industriale dhe Navale"</i>	15
16	<i>MP "Studime te Avancuara Detare"</i>	27
17	<i>MP Mesuesi per Arsimin e Mesem ne Lenden Informatike</i>	39

Totali per FSHT, viti akademik 2014-2015 - 503 studentë të regjistruar

FSHP

<i>Nr.</i>	<i>Fakulteti i Shendetit Publik/Programe studimi</i>	<i>Numri studenteve te regjistruar per vitin akademik 2014-2015</i>
1.	<i>Bch Infermieri e Pergjithshme</i>	171
2.	<i>Bch Infermieri-Mami</i>	54
3.	<i>MP Infermieri Patologjike</i>	50
4.	<i>MP Infermieri Kirurgjikale</i>	34
5.	<i>MP Infermieri Pediatrike</i>	19
6.	<i>MS Shkenca Infermierore</i>	10

Totali per FSHP, viti akademik 2014-2015- 338 studentë të regjistruar

FE

<i>Nr.</i>	<i>Fakulteti I Ekonomisë/Programe Studimi</i>	<i>Numri studenteve te regjistruar per vitin akademik 2014-2015</i>
1.	<i>Bachelor Administrim Biznes</i>	99
2.	<i>Bachelor Ekonomiks</i>	87
3.	<i>Bachelor Finance</i>	185
4.	<i>Bachelor Kontabilitet</i>	22
5.	<i>Bachelor Marketing</i>	37
6.	<i>Bachelor Menaxhim Turizmi</i>	89

7.	<i>MP Ekonomiks në sipërmarrje</i>	<i>17</i>
8.	<i>MP Finance</i>	<i>41</i>
9.	<i>MP Kontabilitet</i>	<i>20</i>
10.	<i>MP Marketing</i>	<i>10</i>
11.	<i>MP Sipërmarrje ne Turizem</i>	<i>12</i>
12.	<i>Msc Administrim-Biznes</i>	<i>14</i>
13.	<i>Msc Ekonomiks</i>	<i>13</i>
14.	<i>Msc Finance</i>	<i>27</i>
15.	<i>Msc Pasuritë e Patundshme</i>	<i>11</i>
16.	<i>MP Administrim Publik</i>	<i>42</i>

Totali per FE, viti akademik 2014-2015- 726 studentë të regjistruar

Totali per FSHH, viti akademik 2014-2015- 943 studentë të regjistruar

<i>Nr.</i>	<i>Fakulteti I Shkencave Humane/Programe studimi</i>	<i>Numri studenteve te regjistruar per vitin akademik 2014-2015</i>
<i>1.</i>	<i>Bachelor ne Drejtesi</i>	<i>155</i>
<i>2.</i>	<i>Bachelor ne Gjuhe Angleze</i>	<i>100</i>
<i>3.</i>	<i>Bachelor ne Gjuhe Italiane</i>	<i>25</i>
<i>4.</i>	<i>Bachelor ne Gjuhe Letersi</i>	<i>86</i>
<i>5.</i>	<i>Bachelor ne Histori - Gjeografi</i>	<i>69</i>
<i>6.</i>	<i>Bachelor ne Mësuesi për Arsimin Fillor</i>	<i>79</i>
<i>7.</i>	<i>Bachelor ne Mësuesi për Arsimin Parashkollor</i>	<i>44</i>
<i>8.</i>	<i>MP ne E Drejtë Penale</i>	<i>53</i>
<i>9.</i>	<i>MP ne Mësuesi për Ciklin e Lartë në Arsimin Bazë ne Gjuhë Italiane</i>	<i>13</i>
<i>10.</i>	<i>MP Mësuesi për Ciklin e Lartë të Arsimit Bazë në Gjuhë Angleze</i>	<i>45</i>
<i>11.</i>	<i>MP ne Mësuesi për Ciklin e Ulët me Profil Minor Parashkollor</i>	<i>135</i>
<i>12.</i>	<i>MP ne Shkenca Administrative</i>	<i>32</i>
<i>13.</i>	<i>Msc ne Edukim</i>	<i>12</i>
<i>14.</i>	<i>Msc ne Marrëdhënie Nderkombetare</i>	<i>19</i>
<i>15.</i>	<i>Msc ne Mësimdhënien e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë</i>	<i>58</i>
<i>16.</i>	<i>Msc ne Pedagogji e specializuar sociale</i>	<i>15</i>
<i>17.</i>	<i>Msc ne Përkthim dhe Interpretim</i>	<i>3</i>

8. Per pyetjen e tete: A keni mbyllur programe studimi per shkak te mungeses se studenteve?, ju bejme me dije se asnje program studimi nuk eshte mbyllur sipas procedurave per mbylljen e programeve të studimit konkretisht- Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 35, “Hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë” dhe Udhëzimit Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe

programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, por me Vendime Senati është vendosur të mos aktivizohen disa programe studimi për vitin akademik 2023-2024 dhe 2024-2025.

9. Për sa i përket pikes së nente: A keni aktualisht programe studimi të nivelit Bachelor me më pak se 10 studentë? Cilat janë ato?

Referuar rezultateve të regjistrimeve të këtij viti akademik, rezulton se ka programe studimi të Ciklit të I të studimeve (Bachelor) që kanë më pak se 10 (dhjete) studentë të regjistruar. Ato programe studimi janë:

	Fakulteti/ Programi i Studimit	Regjistruar gjithsej deri dt 22 Tetor 2024
Nr	Fakulteti i Ekonomise	
1	Kontabilitet	6
	Fakulteti i Shkencave Teknike	
1	Inxhinieri Navale	3
2	Biologji	8
3	Kimi	9
4	Matematike	6
	Fakulteti I Shkencave Humane	
4	Media komunikimi	7
	Totali	39

Menyra e perfundimit :

Me email

Tarifa

Pa pagese

Data e kerkesës:

07.08.2024

Objekti i kërkesës:

Nëse operatori “X” ka përdorur të dhënat e mia si pjesë e stafit teknik në cilësinë e drejtuesit teknik apo si inxhiere mjedisi për procedurën

Data e përgjigjes:

23.08.2024

Përgjigja:

Të dhënat tuaj janë përdorur si inxhiere mjedisi

Menyra e perfundimit :

Me shkresë

Tarifa

Pa pagese

Data e kerkesës:

17.08.2024

Objekti i kërkesës:

Nëse operatori “X” ka përdorur të dhënat e mia si pjesë e stafit .

Data e përgjigjes:

03.09.2024

Përgjigja :

Operatori ka përdorur të dhënat tuaja

Mënyra e perfundimit :

Me shkresë

Tarifa

Pa pagese

Data e kerkesës:

12.12.2024

Objekti i kërkesës:

1.Kopje të kërkesës drejtueses së komanduar të departamentit të Infermierisë Dr.....

Për dorëheqjen nga ky pozicion

2.Miratimin e kërkesës për dorëheqjen nga ky pozicion.

Data e përgjigjes:

19.12.2024

Përgjigja: